

ORION sh.p.k.
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2015

PËRMBAJTJA:

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

FAQE

1

PASQYRA E PERFORMANCËS

2

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

3

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

4

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE

5 - 18


A handwritten signature in blue ink is positioned to the left of a circular blue stamp. The stamp contains the text "ORION SHPK" in the center, with "BANI" at the bottom and "dettim imp exp" along the top arc.

ORION sh.p.k.*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	86,012,250	5,601,946
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	1,237,855,732	1,652,154,025
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	2,459,332	283,306
Inventari	7	16,533,005	15,286,800
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	8	32,123,461	30,000
Total aktive afatshkurtra		1,374,983,780	1,673,356,077
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	9	32,981,566	35,383,375
Aktive afatgjatë jomateriale	10	14,675	17,265
Total aktive afatgjatë		32,996,241	35,400,640
Total aktive		1,407,980,021	1,708,756,717
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	11	18,901	-
Llogari të pagueshme tregtare	12	89,091,990	194,806,416
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	13	217,578,908	219,840,068
Parapagime të arkëtuara	14	678,317,848	899,837,043
Detyrime tatimore	15	1,309,765	2,769,946
Të tjera detyrime	16	23,229,654	23,229,671
Total detyrime afatshkurtra		1,009,547,066	1,340,483,144
Detyrime afatgjatë			
Hua afatgjatë		-	-
Total detyrime afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		1,009,547,066	1,340,483,144
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		39,000,000	39,000,000
Rezerva ligjore		17,488,822	17,488,822
Rezerva të tjera		311,784,751	288,206,698
Fitime të mbartura		-	-
Fitimi i ushtrimit		30,159,382	23,578,053
Total kapitali	17	398,432,955	368,273,573
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,407,980,021	1,708,756,717

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Signature)
 ORION SHPK
 TIRANE



ORION sh.p.k.*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e Performancës****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	53,625,315	309,902,744
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	19	11,272,097	(57,926)
Lënda e parë, materiale dhe shërbime		(7,384,674)	(264,306,871)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	20	(2,257,607)	(252,243,156)
2) Të tjera shpenzime	21	(5,127,067)	(12,063,713)
Shpenzime të personelit	22	(18,023,641)	(13,282,019)
1) Paga dhe shpërblime		(15,807,191)	(11,653,687)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(2,216,450)	(1,628,332)
Zhvierësim i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	23	(2,456,899)	(2,273,387)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	24	(1,332,556)	(1,900,236)
Shpenzime financiare	25	17,141	(8,085)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		17,141	(8,085)
2) Shpenzime të tjera financiare		-	-
Fitimi/humbja para tatimit		35,716,783	28,074,222
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	(5,557,401)	(4,496,169)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(5,557,401)	(4,496,169)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		30,159,382	23,578,053
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		30,159,382	23,578,053

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



ORION sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2013	39,000,000	85,946,190	6,843,532	-	212,905,798	344,695,520
Transferim në rezerva		202,260,508	10,645,290		(212,905,798)	-
Transferim në fitimin e mbartur						-
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:				23,578,053		23,578,053
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014	39,000,000	288,206,698	17,488,822	-	23,578,053	368,273,573
Transferim në rezerva						-
Transferim në fitimin e mbartur		23,578,053			(23,578,053)	-
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin:				30,159,382		30,159,382
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	39,000,000	311,784,751	17,488,822	23,578,053	30,159,382	398,432,955

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori i ORION sh.p.k. më ___ mars 2016 dhe janë firmosur si më poshtë.



[Signature]

Z. Ardian Nelo
Administrator



ORION sh.p.k.*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	30,159,382	23,578,053
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	880,284	
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	2,456,899	2,273,387
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	412,122,267	(278,856,049)
Rënie/(rritje) në inventarë	(1,246,205)	13,908,374
Ndryshimi në parapagime e shpenzime të shtyra	(32,093,461)	60,614,535
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(110,316,068)	66,595,951
Rritje/(rënie) në parapagime të arketuara	(221,519,195)	116,055,946
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	80,443,903	4,170,197
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(52,500)	(7,593,574)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(52,500)	(7,593,574)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Të hyra nga hua afatshkurtra	18,901	-
Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare	-	(2,309,938)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	18,901	(2,309,938)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	80,410,304	(5,733,315)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	5,601,946	11,335,261
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	86,012,250	5,601,946

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "ORION" shpk është regjistruar më 12 Maj 1998 në Regjistrin e Shoqërive me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.19427 datë 12.05.1998.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është ndërtimi dhe importi i materialeve të ndryshme të ndërtimit.

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 39,000,000 lekë i cili zotërohet nga ortakët : Z. Ardian Nelo dhe Z.Alfred Nelo.

Administrator i Shoqërisë është Z.Ardian Nelo.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT J81715002Q. Selia qendrore e saj është në « Rrugën e Kosovarëve », Pallati Orion 2, pranë Kompleksit Dinamo, Tiranë.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 16 (2014:15).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Euro/Lek	137.28	140.14
USD/ Lek	125.79	115.73



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe pajisje	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike dhe teknike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje zyre dhe orendi	Vlera e mbetur	20%
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka qira operative.



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë mbi fitimin.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.



Ndërtim m.p. exp
"ORION SHPK"
TIRANë ALBANIA



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Vlerë monetare në Lekë	4,239,010	675,785
Arka	1,883	1,801
Banka	4,237,127	673,984
Vlerë monetare në Valutë	81,773,240	4,926,161
Arka	172,071	175,656
Banka	81,601,169	4,750,505
	86,012,250	5,601,946

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme përfaqësojnë llogari të arkëtueshme nga klientë dhe koston e punimeve të kryera së bashku me kostot shtesë të investitorit për objektet e përfunduara në datën e mbylljes së Pasqyrave Financiare. Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Klientë	3,925,784	-
Vlera e situacioneve me TVSH dhe kosto shtesë	1,233,929,948	1,652,154,025
	1,237,855,732	1,652,154,025


Ndarim
"ORION SHPK"
TIRANE ALBANIA



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
TVSH	2,176,026	-
Garanci të dhëna	280,100	280,100
Të tjera	3,206	3,206
	2,459,332	283,306

7. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohet si më poshtë :

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Inventar i imët	863,514	863,514
Mallra	15,669,491	14,107,555
Paradhënie për furnizime		315,731
	16,533,005	15,286,800

8. Parapagimet dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Parapagime	17,881,217	30,000
Shpenzime të periudhave të ardhshme	14,242,244	-
	32,123,461	30,000



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

9. Aktive Afatgjata Materiale

	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Pajisje informatike dhe teknike	Mobilje dhe Orendi	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2014	27,233,727	4,730,499	4,139,950	1,094,804	37,198,980
Shtesa	6,768,409		440,397	384,768	7,593,574
Pakësime					
Gjendja më 31 dhjetor 2014	34,002,136	4,730,499	4,580,347	1,479,572	44,792,554
Shtesa			52,500		52,500
Pakësime					0
Gjendja më 31 dhjetor 2015	34,002,136	4,730,499	4,632,847	1,479,572	44,845,054
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2014	1,411,889	2,327,030	2,795,291	604,629	7,138,839
Amortizimi i vitit	1,291,091	480,694	400,520	98,035	2,270,340
Kthim amortizimi					
Gjendja më 31 dhjetor 2014	2,702,980	2,807,724	3,195,811	702,664	9,409,179
Amortizimi i vitit	1,564,958	384,555	349,415	155,381	2,454,309
Kthim amortizimi					
Gjendja më 31 dhjetor 2015	4,267,938	3,192,279	3,545,226	858,045	11,863,488
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 dhjetor 2014	31,299,156	1,922,775	1,384,536	776,908	35,383,375
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	29,734,198	1,538,220	1,087,621	621,527	32,981,566



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

10. Aktive afatgjata jomateriale

	AAJM	Total
Me kosto		
Gjendja më 1 janar 2014	37,800	37,800
Shtesa		
Pakësime		
Gjendja më 31 dhjetor 2014	37,800	37,800
Shtesa	-	-
Pakësime	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	37,800	37,800
Amortizimi		
Gjendja më 1 janar 2014	17,488	17,488
Amortizimi i vitit	3,047	3,047
Kthim amortizimi		
Gjendja më 31 dhjetor 2014	20,535	20,535
Amortizimi i vitit	2,590	2,590
Kthim amortizimi	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	23,125	23,125
Gjendja Neto më 31 dhjetor 2014	17,265	17,265
Gjendja Neto më 31 dhjetor 2015	14,675	14,675

11. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Overdraft nga Credins Bank	18,901	-
	18,901	-

12. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Furnitorë	89,091,990	194,806,416
	89,091,990	194,806,416

13. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Detyrime ndaj ortakëve	217,578,908	219,840,068
	217,578,908	219,840,068



ORION sh.p.k.**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

(Vlerat janë në Lekë)

14. Parapagime të arkëtuara

Në këtë zë janë përfshirë paradhëniet e marra nga klientët për kontrata porosie për blerje apartamentesh, dyqanesh etj, gjendja e të cilave më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Parapagime të marra	678,317,848	899,837,043
	678,317,848	899,837,043

15. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
TVSH për t'u paguar	-	2,281,770
Detyrime për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	305,192	290,653
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	123,289	116,084
Tatimi mbi fitimin	880,284	81,439
Të tjera detyrime	1,000	-
	1,309,765	2,769,946

16. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 për kompaninë vijnë si më poshtë :

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Kreditorë të tjerë	23,197,384	23,197,384
Paga për tu paguar	32,270	32,287
	23,229,654	23,229,671

17. Kapitali

Kapitali i nënshkruar i shoqërise është 39,000,000 Lekë 75 kuota zotërohen nga ortaku Ardian Nelo dhe 25 kuota nga ortaku Alfred Nelo.

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Numri i kuotave	100	100
Vlera nominale (në LEK)	390,000	390,000
Kapitali i nënshkruar	39,000,000	39,000,000

Rezerva ligjore nuk ka ndryshim nga vitit paraardhës, dhe paraqitet në shumën 17,488,822 Lekë.

Rezerva të tjera paraqiten në vlerën 311,784,751 Lekë.

Fitimet e mbartura janë në vlerën 23,578,053 Lekë.





ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

18. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhura nga punimet, situacionet në objekte	-	309,649,154
Të ardhura nga mbyllja e shitjeve të objekteve	53,625,315	253,590
	<u>53,625,315</u>	<u>309,902,744</u>

19. Të ardhura të tjera nga shfrytëzimi

Të ardhurat e tjera nga shfrytëzimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Të ardhurat nga këmbimet valutore nga aktiviteti operativ	9,469,397	(57,926)
Të ardhura nga qiraja	1,802,700	-
	<u>11,272,097</u>	<u>(57,926)</u>

20. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për lëndë të para dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Materiale dhe lëndë të para të konsumuara	2,257,607	252,243,156
	<u>2,257,607</u>	<u>252,243,156</u>

21. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Mirëmbajtje dhe riparime	784,697	1,451,570
Shërbim i sigurimit dhe ruajtjes së objektit	235,000	2,160,000
Shërbime kontabiliteti dhe financiare	1,410,000	1,580,000
Shërbime ligjore	151,540	95,167
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	611,394	881,209
Shpenzime qiraje	-	600,000
Tatime dhe taksa të ndryshme	98,576	402,146
Shërbime bankare	287,560	234,980
Blerje energji, ujë	512,340	463,626
Shpenzime kancelarie	460,090	582,525
Shpenzime për pritje dhe përfaqësim	398,980	371,770
Shpenzime transporti	76,903	2,353,595
Shpenzime të tjera	99,987	887,125
	<u>5,127,067</u>	<u>12,063,713</u>



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

22. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime për paga	15,807,191	11,653,687
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	2,216,450	1,628,332
	<u>18,023,641</u>	<u>13,282,019</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 16 (2014:15).

23. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime amortizimi	2,456,899	2,273,387
	<u>2,456,899</u>	<u>2,273,387</u>

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Gjoba dhe dëmshpërblime	1,332,556	1,900,236
	<u>1,332,556</u>	<u>1,900,236</u>

25. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzimet e interesit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime interesi	-	(8,655)
Të ardhura nga interesat	17,141	570
	<u>17,141</u>	<u>(8,085)</u>



ORION sh.p.k.

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

(Vlerat janë në Lekë)

26. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Fitimi para tatimit	35,716,783	28,074,222
Shpenzime të panjohura	1,332,556	1,900,236
Shpenzime pritje & përcjellje		
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	37,049,339	29,974,458
Tatim fitimi @15%	5,557,401	4,496,169
Fitimi neto	30,159,382	23,578,053

27. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2015	Më 31 dhjetor 2014
Detyrime për dividendë	37,448,752	37,448,752
Hua afatgjate nga ortakët	180,130,156	182,391,316
	217,578,908	219,840,068

28. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2015 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

29. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Handwritten signature and stamp of ORION SHRK, TIRANE, ALBANIA.

